



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:233624  
Datë: 20.11.2024  
Numri i dokumentit: 06483437

Ac.nr.4175/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ylber Shurdhiqi, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Naim Mehulli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Kompana Debt Loan Recovery SH.p.k – i autorizuari D.I., kundër të paditurit A.M.nga fsh. V., lidhur me çështjen juridike rimbursim dëmi, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, C.nr.545/2019, të datës 19.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.11.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurit A. M. nga fsh. V., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, C.nr.545/2019, i datës 19.05.2022, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.545/2019, të datës 19.05.2022, ka vendosur si në vijim: I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Byroja Kosovare e Sigurimeve. II.OBLIGOHET i padituri A. M., që paditësit ti kompensoi shumën prej 1152,00 €, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut me dt. 08.12.2017 në Suharekë. III. Në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar Gjykatës që të aprovohet ankesa e të paditurit dhe të prishet aktgjykimi i atakuar deh çështja të kthehet në rigjykim në shkallën e parë.

Paditësja nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me padinë e paraqitur në gjykatën e shkallës së parë, ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditëses t'ia kompensoj shumën prej 1152.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 08.12.2017 në Prizren.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave, të cekura në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të atakuar, si dhe pas vlerësimit të këtyre provave dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.545/2019, të datës 19.05.2022, me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, ndër të tjera, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat që ka administruar ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të saj, nga arsyet se sipas raportit për aksident 2017..... të dt. 08.12.2017 është vërtetuar se me veprimet e të paditurit ka ardhur deri te aksidenti në komunikacion me dëme materiale dhe jo materiale në atë mënyrë që i padituri duke u kyçur në rrugë nga pompa e benzinës, nuk u jep përparësi automjeteve me të drejtë përparësie që po lëviznin në magjistralen Suharekë-Prizren, pra shkaktar i dëmit ka qenë i padituri. Me konfirmim të policës sigurorese është provuar se automjeti i të paditurit nuk ka pasur mbulesë sigurorese, nga foto dokumentacioni në shkresat e lëndës provohet fakti se dëm material në automjete kanë pësuar R. K. dhe G.T. S. Me ujdite gjyqësore të dt. 05.04.2018 dhe të datës 27.06.2018, urdhër transferet bankare të datave 23.04.2018 dhe 09.07.2018, provohet fakti se të dëmtuarit R. K. dhe G. T. S. për dëmet e pësuar janë kompensuar nga e paditura. Ka shtuar se, Gjykata vlerëson se paditësi nga ky moment kur edhe është bërë pagesa me dt. 23.04.2018 dhe 09.07.2018, fiton të drejtën që të kërkoj rimbursimin e dëmit të kompensuar të dëmtuarit nga këtu i padituri konform nenit 18 par. 4 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia nr. 04/L-018, ku është përcaktuar se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*, paditësi ka të drejtë të kërkoj rimbursimin në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar. Ndërsa në bazë të nenit 136 par.1 të LMD-së *“kush tjetërit i shkakton dëm ka për detyrë ta kompenzoj dëmin ,përveq nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Vendimin mbi shpenzimet procedurale, e ka mbështetur në nenin 452.1 të LPK-së, *(më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar)*.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po

ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadisë së paditëses, e parashtruar kundër të paditurit, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye aktgjykimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi. Gjithashtu, edhe dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin, përkatësisht aktgjykimi është hartuar në përputhje me nenin 160 të LPK-së. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Për sa i përket pretendimit ankimor për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, që i referohen aprovimit të kërkesëpadisë, për shkak se nuk është vërtetuar baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë bazën juridike të kërkesëpadisë e ka vërtetuar përmes raportit të aksidentit nr. 2017... i datës 08.12.2017, ku sipas këtij raporti është vërtetuar se me datë 08.12.2017, me veprimet e të paditurit ka ardhur deri te aksidenti në komunikacion me dëme materiale dhe jo materiale në atë mënyrë që i padituri duke u kyçur në rrugë nga pompa e benzinës, nuk u jep përparësi automjeteve me të drejtë përparësie që po lëviznin në magjistralen Suharekë-Prizren, ku shkaktar i këtij aksidenti ka qenë i padituri, ndërsa të dëmtuar nga ky aksident kanë qenë R. K.dhe G.T.S., ndërsa nga ky aksident ka pasur vetëm dëme materiale. Lartësinë e dëmit e ka vërtetuar nga ujditë jashtë gjyqësore të datave 05.04.2018 dhe 27.06.2018, si dhe nga urdhër transferet bankare të datave 23.04.2018 dhe 09.07.2018, në bazë të të cilit është vërtetuar se pala paditëse e ka paguar shumën e kërkuar sikur se në padi palëve të dëmtuara.

Mbi bazën e të lartcekurave, meqenëse me qëllim të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit, me datë 08.12.2017, paditësja dhe i dëmtuari R. K., më datë 27.06.2018 kanë lidhur ujdi jashtë gjyqësore për kompensimin e dëmit, në shumën e përgjithshme prej 672.00 euro, që i dëmtuari ka pësuar nga aksidenti i trafikut më datë 08.12.2017 në Prizren dhe paditësja me të dëmtuarin G. T. S., me datë 05.04.2018 kanë lidhur ujdi jashtë gjyqësore për kompensimin e dëmit, në shumën e përgjithshme prej 480.00 euro, që i dëmtuari ka pësuar nga aksidenti i trafikut më datë 08.12.2017 në Prizren, fakt ky që vërtetohet nga transferet bankare të datave 23.04.2018 dhe 09.07.2018, së bashku me listën e pagesave, në emër të kompensimit të dëmit sipas afatit të paraparë me ujdi gjyqësore për çka me nenin 18 para. 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia parashihet se: “Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”. Ndërsa parag.4 i nenin 18 të këtij ligji

shprehimisht thotë: “Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”.

Duke u bazuar në të lartcekurat, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses, për Gjykatën e Apelit rezultoi si i drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore të cekura më lartë.

Lidhur me vendimin për shpenzimet procedurale, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat nga neni 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit ka shqyrtuar edhe pretendimin tjetër ankimor lidhur me nxjerrjen e ekspertizës së komunikacionit, për të cilin me anë të ankesës ka pretenduar se nuk ka pasur ekspertizë të komunikacionit, mirëpo Gjykata e Apelit, vlerëson se ky pretendim me anë të ankesës vlerësohet si i pa bazuar, për arsye se propozimi për nxjerrjen e ekspertizës së komunikacionit ishte dashur që të propozohet gjatë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht një propozim i tillë nuk mund të paraqitet me ankese, ngase me nenin 180 par.1 të LPK-së përcaktohet: *“Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë”*. Andaj, pala e paditur edhe nëpërmes ankesës nuk ka arritur të provoj me asnjë provë se pa fajin e vet nuk ka mundur t’a paraqesë, përkatësisht t’ë propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë propozimin për nxjerrjen e ekspertizës së komunikacionit.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.4175/2022 me dt.18.11.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari,  
Ylber Shurdhiqi